



Një vend për t'u rritur:
Komuna kushtuar
fëmijëvet

TRAJNIME PËR PROMOVIMIN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE, PËR PËRFAQËSUESIT E STAFIT ARSIMOR NË KOMUNAT VELES, VINICË, DIBËR, GOSTIVAR, KISELLA VODË

Në periudhën prej 16.11.2023 - 18.01.2024 në Veles, Gostivar, Dibër, Vinicë, Kisella Vodë, janë mbajtur një sërë trajnimesh për forcimin e kapaciteteve të stafit arsimor në këto komuna - përkrahës të projektit: Një vend për t'u rritur - Komuna kushtuar fëmijëve.

Gjatë sesioneve, pjesëmarrësit ndanë përvojën e tyre praktike, diskutuan të drejtat dhe pjesëmarrjen e fëmijëve, si dhe zhvilluan mekanizma të ri për promovimin e të drejtave të fëmijëve dhe përfshirjen e fëmijëve në proceset e planifikimit lokal nëpërmjet procesit arsimor.

Në këto trajnime janë përfshirë 97 arsimtarë/e, profesorë/e, edukatorë/e, kujdestarë/e, bashkëpunëtorë/e profesionalë/e dhe përfaqësues të tjerë të procesit arsimor.

Institucionet arsimore kanë rol të rëndësishëm në krijimin e mjediseve dhe kushteve të përshtatshme për realizimin e të drejtave të fëmijëve.



TRAJNIME PËR PROMOVIMIN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE, PËR PËRFAQËSUES TË PUSHTETEVE LOKALE NË KOMUNAT VELES, VINICË, DIBËR, GOSTIVAR, KISELLA VODË

Në periudhën prej 16.11.2023 deri më 18.01.2024 janë mbajtur një sërë trajnimesh në Veles, Gostivar, Dibër, Vinicë, Kisella Vodë për rolin e njësive të vetëqeverisjes lokale në realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe përfshirjen aktive të fëmijëve në proceset e planifikimit.

Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte të forcohen kapacitetet për realizimin dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve nëpër komuna dhe çështjeve që lidhen me fëmijët t'u jepet vend qendror në procesin e planifikimit lokal.

Trajnimet paraqesnin mundësi për bashkëpunim ndërsektorial, ndërtim të strategjive për krijimin e një komune kushtuar fëmijëve. Mundësuan komunikim dhe diskutim të hapur për të drejtat dhe pjesëmarrjen e fëmijëve, si dhe u zhvilluan mekanizma të ri për promovimin e të drejtave të fëmijëve dhe përfshirjen e fëmijëve në proceset e planifikimit vendor.

Në këto trajnime janë përfshirë 54 persona – përfaqësues të vetëqeverisjes lokale.

Vetëqeverisja lokale ka autoritetin dhe përgjegjësinë të ndikojë në cilësinë e jetës së fëmijëve!





Një vend për t'u rritur: Komuna kushtuar fëmijëvet



TRAJNIME PËR TRAJNERË/E

Në periudhën prej 22 deri më 24.01.2024 është mbajtur trajnimi për trajnerë në të cilin përfaqësues nga vetëqeverisja lokale dhe institucionet arsimore nga komuna e Vinicës, komuna e Dibrës, komuna Velesit, komuna e Kisella Vodës, komuna e Gostivarit - dhe BNJVL.

Qëllimi i trajnimit ishte rritja e nivelit të njohurive në fushat e të drejtave të fëmijëve, zhvillimi i aftësive që do të forcojnë kapacitetet e tyre për të realizuar vizionin e qyteteve miqësore për fëmijët, duke i përdorur në punën e përditshme me institucione arsimore dhe të tjera, me grupe të fëmijëve dhe të rinjve, si dhe transferimi i njohurive dhe aftësive në njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore. Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit konceptuan punëtori të cilat më vonë do t'i zbatojnë në komunat e tyre apo në komunat e tjera.

Procesin e përfunduar me një vizitë në Komunën e Ohrit, ku përveç shkëmbimit të praktikave të mira ndërsektoriale, diskutuam edhe sfidat e mundshme në krijimin e komunave kushtuar fëmijëve.

Trajnimin për trajnerë e përfunduar me sukses 14 pjesëmarrës nga vetëqeverisja lokale dhe stafi arsimor nga të pesë komunat e përfshira në proces/në kuadër të projektit.



ÇFARË THONË PJESËMARRËSIT PËR TRAJNIMET?

"Dy ditë, kaluan si dy orë. Faleminderit Një vend për t'u rritur - Ekipi që duhet mbajtur mend, vazhdoni të përhapni dashuri dhe buzëqeshje për hir të fëmijëve."

"Kreativiteti, energjia dhe e ardhmja e komunës së Vinicës gjenden tek të rinjtë! Të rinjtë meritojnë mbështetje mentore për projektet dhe iniciativat e tyre!"

"Metodologji e ndryshme, shkëmbim përvojash nga praktika e mirë dhe e gjithë kjo në një atmosferë të mrekullueshme"

Burim: Koment në faqen e fejsbukut të [Një Vend për t'u Rritur](#)



Projekti financohet nga
Bashkimi Evropian

